



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 7831/prot.  
3

Himarë, më 13.12.2024

### PROJEKTVENDIM

Nr. 43 datë, 13.12.2024

### PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2025

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”,

#### VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 25 punonjës në total.
2. Nga këta 15 punonjës sezonal për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, 3 edukatore kopshti zëvendësuese ose ndihmëse dhe 7 roje pyjesh sezonal.
3. Paga do të bëhet bazuar në vendimin nr. 28, datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë”.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2025.
5. Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Mahametaj

Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 7831/prot.  
4

Himarë, më 13/12 .2024

**RELACION SQARUES**

**Lënda:** Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**

Në mbështetje të nevojave që ka bashkia për mirëmbajtjen e territorit të saj gjatë sezonit turistik, mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret gjatë stinëve të ngrohta të vitit dhe mbarëvajtjen e punës të institucioneve arsimore nën administrimin e Bashkisë Himarë është menduar që të shtohet forca punëtore duke punësuar përkatësisht: 7 punonjës roje pyjesh sezonal; 3 edukatore kopshti zëvendësuese ose ndihmëse, të cilat nevojiten për, për të zëvendësuar edukatorët të cilat marrin lejen e lindjes, si dhe edukatore ndihmëse për fëmijët me aftësi ndryshe dhe 15 punonjës sezonal për mirëmbajtjen dhe pastrimin e plazheve publike dhe për parkimet publike.

Edukatoret zëvendësuese ose ndihmëse dhe rojet e pyjeve do të emërohen nga Bashkia Himarë, kurse 15 punonjësit sezonal do të emërohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, e cila do të jetë në varësi të Bashkisë Himarë. Formimi dhe funksionimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është paraqitur për miratim në mbedhjen e datës 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak.

Këta punonjës do të emërohen sipas nevojave me kontratë të përkohshme në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Për sa më sipër numri total i punonjësve me kontratë pune të përkohshme, jashtë shtrukturës të bashkisë për vitin 2025, propozojmë të jetë 25 punonjës.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani